

## **Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin e Almerias, në Spanjë, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Almerias në kuadër të programit Erasmus +, për studentët e Universitetit të Tiranës për studime, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.

<http://cms.ual.es/UAL/en/index.htm>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;

\*Studentët e vitit të tretë nuk mund të aplikojnë!

### **Kohëzgjatja e bursave:**

-Bachelor (1 semestër);

### **Fushat e studimit:**

- Ekonomiks;
- Kontabilitet;
- Financë;
- Manaxhim dhe Administrim;
- Marketing;
- Turizëm;
- Gjuhë angleze;
- Gjuhë spanjolle.

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Almerias në gjuhën angleze, klikoni në adresën:

[https://www.ual.es/application/files/4916/1796/8360/Listado\\_Plurilinguismo\\_2021-22-1.pdf](https://www.ual.es/application/files/4916/1796/8360/Listado_Plurilinguismo_2021-22-1.pdf)

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:**

- CV (në gjuhën angleze / spanjolle);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit i nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / spanjolle);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / spanjolle);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze / spanjolle);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (gjuhës angleze apo spanjolle);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Almerias lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studentit bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

**Afati për aplikim: 17 Maj 2021**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!